



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosova/ Republic of Kosovo*  
*Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality*



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

02 Nr. Br. 100/bi-6/23/24  
13.03-2024

**Dragash - Dragaš**

**Datë: 13/03/2024**

**Dragash**

Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-40, dhe nenit 12 të rregullores mbi kriteret standardet the procedurat e financimit publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

## **V E N D I M**

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare për projekte të organizatave jo - qeveritare në fushën e Sportit.

### **I**

Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë për Kulture Rini dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nën programit 85009/0820,

### **II**

Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

### III

Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

Formularët e aplikimit, referuar paragrafit të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Forma e deklaramit të konfliktit të interesit
5. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
6. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
7. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim

Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

### IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (<https://kk.rks-gov.net/dragash/>)

## V

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

## VI

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit bie vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

## VII

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit



*Kryetari i Komunës*  
**Bexhet Xheladini**